URDHËR
Nr. 2022, datë 8.11.2024

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRIT NR. 1421, DATË 22.8.2024

Në mbështetje të nenit 28, germa "d", të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave"; germës "c", të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, "Për Kadastrën"; të neneve 22, 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 1421, datë 22.8.2024, "Për delegim kompetence", z. Enis Hoxha.
2. Ngarkohet z. Enis Hoxha, Drejtoria e Kadastrës dhe Monitorimit të Titujve të Pronësisë, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli